



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:083865

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05608881

P.nr.57/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit R.H. nga Komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr.297/24 të datës 14.03.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 19.04.2024, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurori i Shtetit Arjan Xhema, i pandehuri R.H., mbrojtësi i të pandehurit sipas detyrës zyrtare av.Beqir Halili, i dëmtuari F.S. si dhe i dëmtuari G.S., në po të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 23.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: R.H., me nofkën “R...”, nga i ati B., e ëma H., e gjinisë H., i lindur më datë ... në Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, tani me vendbanim në komunën e Vushtrrisë, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e lartë ekonomike, i martuar, prind i gjashtë fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i pa gjykuar, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datë 23.02.2024, rreth orës 19:30, në fshatin Verrnicë, Komuna Vushtrri, i pandehuri me dashje ka kanosur personat zyrtar – zyrtarët policor F. dhe G.S. se do t’i privojë nga jeta, në atë mënyrë që kishte shkuar në shtëpinë e të dëmtuarve me pretekstin që të biseduar në lidhje me rastet që ishin iniciuar një ditë më parë brenda Stacionit Policor në Vushtrri, ku fillimisht ju drejtohet me fjalët “ti F.S. më ke borxh së bashku me djalin tuaj dhe po të tregoj se kjo punë nuk do të ndalet qitu dhe ju të dy do të keni pasoja nga unë, prej këtij momenti nuk do të kalojmë mirë së bashku”, pastaj edhe të dëmtuarit G.S. duke i thënë se “ti nesër mos u nis me shku për punë se nuk të garantoj kurgjo për tash e mas dhe se konflikti është i gatshëm dhe qitu nuk ndalet, se nuk do të kthehesh gjallë”, me të cilat veprime të dëmtarëve ju ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri,

- Me këtë ka kryer veprën *Kanosja* nga neni 181 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe neni 181 par.2 lidhur me par.3 të KPRK-së, si dhe neni 241, 242, 364, 449 dhe 460 të KPPK-së, e

**G J Y K O N**

Të pandehurit: R.H. i shqipton DËNIM MË BURG në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese në periudhën prej një (1) viti.

Palët e dëmtuara kanë hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

#### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsytuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.297/24 e datës 14.03.2024, kundër të pandehurit R.H. nga Komuna e Vushtrrisë.

Gjykata me datë 19.04.2024 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit Arjan Xhema, i pandehuri A.M., mbrojtësi i të pandehurit sipas detyrës zyrtare av.Beqir Halili, i dëmtuari F.S. si dhe i dëmtuari G.S..

#### *Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë*

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më datë 19.04.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në kuptim të neni 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që: I pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar thellë për kryerjen e veprës penale, duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritet më, njëherit ju ka kërkuar ndjesë të dëmtuarve.

#### *Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë*

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tij, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë si dhe i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese, dhe rrethanat rënduese të cekura si në aktakuzë.

I dëmtuari i parë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se heq dorë nga kompensimi i dëmit lidhur me këtë çështje penale, raportet me të pandehurin janë të mira dhe shpreson se do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

I dëmtuari i dytë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se heq dorë nga kompensimi i dëmit lidhur me këtë çështje penale, raportet me të pandehurin janë të mira dhe shpreson se do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Mbrojtësi i të pandehurit sipas detyrës zyrtare lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimin të fajësisë ashtu që i ka propozuar gjykatës që të miratojë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, më tej ka shtuar se me rastin e vendosjes të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata të marr parasysh se i njëjti është mbajtës i familjes, moshë e tij dhe fakti se i njëjti nuk ka rënë ndesh më parë me ligjin, është penduar për kryerjen e veprës penale dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do të kryejë vepër tjetër penale.

#### *Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit, me nr. të rastit 2024-BD-182, i datës 23.02.2024, raport i oficerit, i datës 23.02.2024, raport i oficerit, i datës 23.02.2024, raport i shpejtë, i datës 23.02.2024, procesverbal i marrjes në pyetje për të pandehurin, i datës 23.02.2024, procesverbal i marrjes në pyetje për të dëmtuarin F.S., i datës 22.02.2024, , informacionet për të kaluarën kriminale për të pandehurin, procesverbal për marrjen në pyetje së të pandehurit, nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë, i datës 08.03.2024.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri nga me dashje ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.3 lidhur me par.2 të KPRK -së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 181, par.2 të KPRK-së është përcaktuar se veprën penale e kryen “*Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t’i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit*”, ndërsa si formë tjetër e kualifikuar e kësaj vepre është përcaktuar në par.3 të këtij neni i cili parasheh se: “*Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj personit zyrtar në lidhje me punën apo me pozitën e tij ose ndaj disa personave ose kur vepra kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*”, e kjo formë e kualifikuar e kësaj vepre penale ka ardhur në

shprehje për arsye se palët e dëmtuara janë persona zyrtar, të cilët janë kanosur nga i pandehuri lidhur me punën e tyre.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Kanosja nga neni 181 par.2 lidhur me par.3 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

#### *Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, si dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, ndërsa si rrethana rënduese sa i përket të pandehurit gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur si dhe shkallën e përgjegjësisë penale, në këtë rast vepra është kryer kundër personave zyrtarë - zyrtarëve policorë, lidhur me punën që janë të autorizuar ta kryejnë, e duke konsideruar të gjitha këto rrethana gjykata vlerësoi se janë plotësuar edhe kushtet nga neni 47, 48 e 49 qe te pandehurit t'i shqiptohet dënim i kushtëzuar.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burgim prej dhjetë (10) muaj, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej një (1) viti, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për pjesën se palët e dëmtuara kanë hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 460 par.1 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal  
P.nr.57/2024, datë 23.04.2024

GJYQTARI  
Agron Maxhuni

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimet të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.